



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 49

Datë 10 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 33/2014 datë 3.4.2014	Për miratimin e huamarrjes prej 295 420 000 SDR-sh, që Fondi Monetar Ndërkombëtar i akordon Shqipërisë për programin 36-mujor të ndihmës (EFF)	2001
Dekret nr. 8535 datë 8.4.2014	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit	2001
Dekret nr. 8529 datë 3.4.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2001
Vendim i KM nr. 183, datë 2.4.2014	Për miratimin e marrëveshjes shtesë të financimit dhe projektit, të nënshkruar më 13 dhjetor 2007, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Ujësjetës-Kanalizime Shkodër, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Mbrojtja mjedisore e liqenit të Shkodrës”	2002
Udhëzim i BSH nr. 2, datë 27.3.2014	Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë...	2005
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Vahit Bardhi	2007

LIGJ
Nr. 33/2014

**PËR MIRATIMIN E HUAMARRJES PREJ
295 420 000 SDR-SH, QË FONDI MONETAR
NDËRKOMBËTAR I AKORDON SHQIPËRISË PËR
PROGRAMIN 36-MUJOR TË NDIHMËS (EFF)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 2, 84, pika 4,
dhe 156 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet huamarrja prej 295 420 000 (dyqind e
nëntëdhjetë e pesë milionë e katërqind e njëzet mijë) SDR-
sh, që Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) i akordon
Shqipërisë për programin 36-mujor të ndihmës (EFF) me
termat, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 3.4.2014

ANEKSI 1

Termat e huas paraqiten si më poshtë:

Shuma e huas 295 420 000 (dyqind e nëntëdhjetë e
pesë milionë e katërqind e njëzet mijë) SDR.

Norma e interesit është e lidhur me normën e
interesit për SDR, që aktualisht është 1,13 %. Ky
interes do të paguhet për shumën e kredisë së tërhequr
dhe të pashlyer deri në masën 180 000 000 SDR (që
përbën 300 % të kuotës së anëtarësisë).

Për pjesën e huas të tërhequr dhe të pashlyer mbi
shumën e mësipërme, aplikohet një interes i barabartë me
normën bazë + 200 bp. Në rastet kur shumën e kredisë së
tërhequr dhe të pashlyer kalon vlerën 180 000 000 SDR
për një periudhë mbi tre vjet, norma shtesë që aplikohet
mbi normën bazë të referencës rritet në 300 bp.

Komisioni i angazhimit aplikohet në çdo fillim
periudhe 12-mujore nga data e miratimit të huas në
Bordin e FMN-së, mbi shumën që parashikohet të
tërhiqen gjatë kësaj periudhe. Norma e këtij komisioni
është 15 bp (0,15 %) për shumën të angazhuara që nuk e
kalojnë vlerën prej 120 000 000 SDR-sh (që përbën 200
% të kuotave të anëtarësisë së Shqipërisë në FMN),
ndërsa për shumën të angazhuara që e kalojnë këtë vlerë,
norma e komisionit rritet në 30 bp (0,3 %).

Ky komision i rimburohet vendit në rast se tërhiqet
e gjithë shumën e huas së angazhuar brenda afatit të

parashikuar.

Komisioni i shërbimit aplikohet mbi çdo shumë që
tërhiqet nga huaja dhe është në masën 50 bp (0,5 %).

Maturimi i huas është 13 vjet dhe përfshin një grace-
periode prej 4 vjetësh.

DEKRET

Nr. 8535, datë 8.4.2014

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË
TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4 dhe nenit 93 të
Kushtetutës së Shqipërisë, bazuar në kërkesën e Kuvendit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 33/2014 “Për miratimin e
huamarrjes prej 295 420 000 SDR-sh, që Fondi Monetar
Ndërkombëtar i akordon Shqipërisë për programin 36-
mujor të ndihmës (EFF)”.

Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të
ligjit nr. 33/2014 “Për miratimin e huamarrjes prej
295 420 000 SDR-sh, që Fondi Monetar Ndërkombëtar i
akordon Shqipërisë për programin 36-mujor të ndihmës
(EFF)”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8529, datë 3.4.2014

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të
Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë
5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar
edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme dhe
ministrit të Arsimit e Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave
të mëposhtëm:

1. Mevlan Sami Murati
2. Ertan Qenan (Kjenan) Demiri
3. Ersen Nemetulla Sali
4. Nevin Ahmet Erdem

5. Azem Rizah Syla
6. Hasime Hasan Berisha
7. Mejreme Hasan Sagici Berisha (Berisha)
8. Izzet Serhat Doğan Demir
9. Abdi Hüseyin Karayel
10. Belgin Metin Karayel (Çimen)
11. Cemil Şükrü İkili
12. Kremena Atanas Zagali (Zareva)
13. Nexhmije Vejsel Pagarusha (Pagarushë)
14. Tarik Vesel Pagarusha
15. Murat Binali Çakmak
16. Mohammad Obaiul Fazlul Karim
17. Arzuda Mirabdur Karim

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 183, datë 2.4.2014

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHITESË
TË FINANCIMIT DHE PROJEKTIT, TË
NËNSHKRUAR MË 13 DHJETOR 2007,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE E
UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR, DHE KFW
FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E
PROGRAMIT “MBROJTJA MJEDISORE E
LIQENIT TË SHKODRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes shtesë të financimit dhe projektit, të nënshkruar më 13 dhjetor 2007, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Ujësijellës-Kanalizime Shkodër, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Mbrotjtja mjedisore e liqenit të Shkodrës”, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCË E PËRDITËSUAR 3 E MARRËVESHJES SË VEÇANTË

Furnizimi me ujë dhe mbrotjtja mjedisore e liqenit të Shkodrës (BMZ-ID 2002 666 76, 2020 597 72, 2020 598 71)

FINANCIMI I KOSTOS

		202059871 (ADA)	202059772 (SECO)	200266676 (KfW)
Kostoja e përgjithshme fillestare dhe financimi i Marrëveshjes së Financimit Shtesë		16.450.000,00 €	3.000.000,00 €	7.500.000,00 €
Kostoja e përgjithshme e përditësuar dhe financimi		19.450.000,00 €		3.000.000,00 €
Kontrata 1:	Furnizimi me mjete të pastrimit të kanalizimeve	482.300,56 €		482.300,56 €
Kontrata 2:	Shkëputja e kullimeve të ujit të stuhive	62.249,79 €		62.249,79 €
Kontrata 3:	Furnizimi me ujë dhe kanalizimet Shkodër	10.212.254,12 €		5.109.214,43 €
Vlera origjinale		8.944.558,46 €		
Porositë e nënshkruara të ndryshimit		-409.591,11 €		
Porositë e pritshme të ndryshimit		1.677.286,77 €		
Kontrata 4:	Kanalizimet dhe WWTP Shirokë	2.863.626,03 €		2.863.626,03 €
Vlera origjinale		2.308.052,64 €		
Porositë e nënshkruara të ndryshimit		304.342,64 €		
Porositë e pritshme të ndryshimit		251.230,75 €		
Kontrata 5:	Furnizimi dhe instalimi i matësve të ujit	2.278.237,06 €		816.216,75 €
Vlera origjinale		1.462.020,31 €		
Porositë e nënshkruara të ndryshimit		211.216,75 €		
Porositë e pritshme të ndryshimit		605.000,00 €		
Kontigjencat:		265.234,44 €		265.234,44 €
Vlera		216.701,96 €		
Rritja		48.532,48 €		
Shërbimet e konsulencës:		3.286.098,00 €		901.158,00 €
Vlera fillestare		2.130.775,00 €		
Shtesat e nënshkruara		737.373,00 €		
Shërbimet shtesë		417.950,00 €		
		1.730.000,00 €	7.220.000,00 €	7.500.000,00 €
		0,00 €	0,00 €	3.000.000,00 €
		0,00 €	0,00 €	482.300,56 €
		1.613.816,69 €	3.489.223,00 €	5.109.214,43 €
		0,00 €	0,00 €	2.863.626,03 €
		116.183,31 €	1.345.837,00 €	816.216,75 €
		0,00 €	0,00 €	265.234,44 €
		0,00 €	2.384.940,00 €	901.158,00 €

* Kontributi financiar shtesë, që është 3.000.000.00 €, do të përdoret për të financuar punët dhe shërbimet shtesë sipas kontratave përkatëse (të gjitha vlerat janë theksuar me blu).

Ujësjellës-Kanalizime Shkodër (UK Shkodra)
3 Heronjtë
Shkodër
Shqipëri

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
Blvd. "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë
Shqipëri

LEa4 – Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Furnizimi me ujë dhe mbrojtja mjedisore e liqenit të
Shkodrës

(BMZ-Nr. 2002 666 76, 2020 597 72, 2020 598 71)

Ndryshim i Marrëveshjes së Veçantë

Datë:
Sfera e aktivitetit
KfW Entwicklungsbank
Marie-Lena Glass
Tona: HaLe
Tel. +49 69 7431 9251
Faks +49 69 7431 2547
marie-lena.glass@kfw.de

Ndryshimi nr. 2 i Marrëveshjes së Veçantë, i datës 13 dhjetor 2007 ("Marrëveshja e Veçantë") i Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë, të datës 13 dhjetor 2007 ("Marrëveshja e Financimit dhe Projektit") dhe i Marrëveshjes së Financimit Shtesë ("Marrëveshja e Financimit Shtesë") të Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit, që duhet të lidhet ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë.

Preambulë

Më 13 dhjetor 2007, u lidh një Marrëveshje e Veçantë për Projektin "Furnizimi me ujë dhe mbrojtja e liqenit të Shkodrës" ("Projekti") ndërmjet KfW-së dhe ndërmarrjes së furnizimit me ujë UK Shkodër (UKS) dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave. Më 1 tetor 2010 u përfundua Ndryshimi nr. 1 i Marrëveshjes së Veçantë ndërmjet KfW-së, UKS-së dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave. Marrëveshja e Veçantë dhe Ndryshimi nr. 1 i Marrëveshjes së Veçantë përbëjnë një shtojcë të Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit dhe të Marrëveshjes së Financimit Shtesë, Marrëveshjes së Projektit ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike ("SECO") dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të datës 22 janar 2008, dhe të Marrëveshjes së Projektit ndërmjet Agjencisë Austriake për Zhvillim ("ADA") dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të datës 7 janar 2008.

Në lidhje me rritjen e kontributit financiar fillestar të Bashkëpunimit Financiar Gjerman brenda Projektit nga 3.0 milionë euro në 10.5 milionë euro, UKS-ja dhe KfW-ja kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme për përdorimin e kontributit financiar shtesë:

Kontributi financiar shtesë do të përdoret për të mbuluar shpenzime më të larta në lidhje me zbatimin e masave të parashikuara në Marrëveshjen e Veçantë dhe ndryshimin e Marrëveshjes së Veçantë të datës 1 tetor 2010. Gjithashtu, fondet do të përdoren për instalimin e rreth 21.400 matësve të rinj të ujit në vend të 15.500, dhe shërbimet e konsulencës që kërkohen për zbatimin dhe fuqizimin institucional.

Seksioni 1

Ndryshimet e Marrëveshjes Shtesë

Dispozitat e mëposhtme të Marrëveshjes Shtesë që ndryshohet nga Ndryshimi i Marrëveshjes Shtesë, të datës 1 tetor 2010, ndryshohet si më poshtë:

1. Seksioni I, neni 1 "Hollësitë e Projektit" të Marrëveshjes së Veçantë

Pika e pestë e seksionit me titull "Komponenti i furnizimit me ujë", në faqen 4, zëvendësohet në tërësinë e tij me tekstin e mëposhtëm dhe paraqitet si më poshtë:

"- Instalimi i rreth 21,400 matësve të rinj të ujit;"

2. Seksioni I, neni 3 "Kostoja dhe financimi i plotë" i Marrëveshjes së Veçantë

Paragrafi i parë i këtij neni zëvendësohet në tërësinë e tij me tekstin e mëposhtëm dhe paraqitet si më poshtë:

"Kostoja e parashikuar e Projektit ("Kostoja e përgjithshme") është afërsisht 19,950,000 euro. Shuma e Kontributit Financiar të ADA-s do të jetë 1,730,000 euro (kontributi për koston e drejtpërdrejtë të Projektit). Shuma e Kontributit Financiar të SECO-s do të jetë 7,220,000 euro. Shuma e Kontributit Financiar nga fondet e Bashkëpunimit Financiar Gjerman do të rriten nga 3,000,000 euro në 10,500,000 euro (Marrëveshja Financiare Shtesë mbetet për t'u përfunduar). Një kontribut përkatës shqiptar që arrin në 500,000 euro do të përdoret për të financuar pjesët e mbetura të komponentëve të kanalizimeve dhe furnizimit me ujë."

3. Shtojca 2 "Grafiku kohor" i Marrëveshjes së Veçantë

Grafiku kohor për zbatimin e Projektit përditësohet pas nënshkrimit të Marrëveshjes Financiare Shtesë dhe pasi të jenë përfunduar shtesat në kontratat përkatëse të furnizimit, të punës dhe të konsulencës. Ky grafik i përditësuar kohor me marrëveshje me shkrim zëvendëson shtojcën 2 të Marrëveshjes së Veçantë në tërësinë e saj dhe bëhet pjesë përbërëse dhe konsiderohet si shtojcë e kësaj Marrëveshjeje të Veçantë si shtojca e re 2.

4. Aneksi 3 "Kostoja dhe financimi i përgjithshëm" i Marrëveshjes së Veçantë

Përbërja e koston së përgjithshme dhe planit financiar përditësohet pas nënshkrimit të Marrëveshjes Financiare Shtesë dhe pasi të jenë përfunduar shtesat në kontratat përkatëse të furnizimit, punës dhe konsulencës. Ky plan i përditësuar i koston dhe i financimit të përgjithshëm, me marrëveshje me shkrim, zëvendëson shtojcën 3 të Marrëveshjes së Veçantë në tërësinë e saj dhe bëhet pjesë përbërëse dhe konsiderohet të jetë shtojcë e kësaj Marrëveshjeje të Veçantë si shtojca e re 3.

Seksioni 2
Detyrimet në vazhdim

Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes së Veçantë, që ndryshohen me Ndryshimin e Marrëveshjes së Veçantë, të datës 1 tetor 2010, mbeten të pandryshuara dhe vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Jeni të lutur të jepni pëlqimin tuaj për ndryshimin e mësipërm, duke sigluar kopjet e bashkëlidhura të këtij Ndryshimi nr. 2, në një formë ligjërishit detyruese dhe duke i kthyer një kopje origjinale KfW-së.

Jeni të lutur t'i dërgoni për dijëni një kopje të këtij dokumenti në kohën e duhur konsulentit.

KfW-ja do t'i dërgojë një kopje të dokumentit të nënshkruar ADA-s dhe SECO-s.

Me respekt,

KfW

René Eschemann

Marie-Lena Glass

(Drejtor i Zyrës së KfW-së Tiranë) (Menaxhere Projekti)

Lexuar dhe rënë dakord për UK Shkodër

Datë

UK Shkodër

Lexuar dhe rënë dakord për Republikën e Shqipërisë

Datë

Ministri i Financave

MARRËVESHJE FINANCIARE SHITESË
datë _____

Për Marrëveshjen e Financimit dhe Projektit, të datës 13 dhjetor 2007, ndërmjet KfW, Frankfurt am Main ("KfW") dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave ("Përfituesi" dhe Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër (UK Shkodër) ("Agjencia e Zbatimit të Projektit") për 3,000,000 euro

- Mbrojtja mjedisore e liqenit të Shkodrës -

Mbi bazën e një marrëveshjeje që duhet të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Qeverisë së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar ("Marrëveshje Qeveritare"), Përfituesi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja lidhin Marrëveshjen e mëposhtme Financiare Shtesë.

Seksioni 1

Ndryshimet e Marrëveshjes së Financimit

Dispozitat e mëposhtme të Marrëveshjes së Financimit, të datës 13 dhjetor 2007, për 7.5 milionë euro, ndryshohet si më poshtë:

a) Neni 1.1, fjalia 1 zëvendësohet në tërësinë e saj me tekstin e mëposhtëm:

"KfW-ja i jep Përfituesit një kontribut financiar që nuk kalon 10.5 milionë euro".

b) Neni 1.2 zëvendësohet në tërësinë e tij me tekstin e mëposhtëm:

"Përfituesi e kanalizon kontributin financiar tërësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit e përdor kontributin financiar ekskluzivisht për financimin e rehabilitimit dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve të qytetit të Shkodrës dhe lokaliteteve të Dobracit dhe të Shirokës, ndërtimin e Njesisë së Trajtimit të Mbetjeve Ujore në Shirokë dhe pajisjet e impiantit, si dhe fuqizimin institucional të UK Shkodër ("Projekti"). Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga kontributi financiar me një marrëveshje të veçantë që duhet të bihet dakord nga Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave."

c) Neni 3.2 zëvendësohet në tërësinë e tij me tekstin e mëposhtëm:

"KfW-ja ka të drejtën të refuzojë kryerjen e livrimeve pas datës 31 dhjetor 2014."

Seksioni 2
Vlefshmëria në vazhdim e Marrëveshjes së Financimit

Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes së Financimit, të datës 13 dhjetor 2007, mbeten të pandryshuara dhe në fuqi dhe efekt të plotë.

Seksioni 3
Dispozitë shtesë

3.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit i ofron menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, e cila është e nevojshme për këtë qëllim.

Për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emër dhe për llogari të saj. Në lidhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit:

a) Burimet e veta të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ose shumat e investuara në financimin e Projektit nuk do të jenë me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, kjo listë, duke mos qenë shteruese, nuk do të lidhen me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

b) Kapitali aksionar i Agjencisë së Zbatimit të Projektit nuk do të jetë në asnjë rast me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, kjo listë, duke mos qenë shteruese, nuk do të lidhet në asnjë rast me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk përfshihet në përfitim, zotërimin ose përdorimin e pronës që është me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, kjo listë, duke mos qenë shteruese, nuk do të lidhet me trafikimin e drogës,

korruptionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin; dhe

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të përfshihet në financimin e terrorizmit.

3.2 Neni 6 (Deklarimet Kontraktuale dhe Prokura) dhe neni 9 (Dispozita të Ndryshme) të Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit zbatohen për këtë Marrëveshje Financimi Shtesë si të jenë parashikuar këtu plotësisht dhe sikur referencat në këto klauzola të “kjo Marrëveshje” të ishin referenca në këtë Marrëveshje Financimi Shtesë.

Seksioni 4

Hyrja në fuqi dhe prishja e Marrëveshjes

4.1 Marrëveshja e Financimit Shtesë nuk hyn në fuqi derisa të ketë hyrë në fuqi Marrëveshja Qeveritare ku ajo bazohet.

4.2 Marrëdhëniet juridike, të vendosura nga kjo Marrëveshje Financimi Shtesë, ndërmjet KfW-së dhe Përfituesit pushojnë me përfundimin e kohëzgjatjes së dobishme të Projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, më _____ 2013

Tiranë më _____ 2013

KfW Ministria e Financave

Emri: René Eschemann Emri:

Titulli:

Titulli: Drejtor i Zyrës së KfW-së, Tiranë

Emri: Marie-Lena Glass UK Shkodër

Titulli: Menaxhere Projekti Emri:

Titulli:

UDHËZIM

Nr. 2, datë 27.3.2014

PËR EKZEKUTIMIN E DETYRIMEVE MBI SHUMAT E LLOGARIVE NË BANKË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 600 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 12, shkronja “a” dhe neni 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Banka e Shqipërisë

UDHËZON:

1. Objekti

Ky udhëzim ka për objekt përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit mbi shumat e llogarive në bankë.

2. Subjektet

Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë.

3. Përkufizime

Në zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Bankë” është subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë bankare në Republikën e Shqipërisë;

b) “Debitor” është personi fizik apo juridik kundrejt llogarive, ekzistuese ose të ardhshme, të të cilit është lëshuar një urdhër për vendosjen e sekuestros nga ana e përmbauesit gjyqësor;

c) “Sekuestro” është bllokimi i përkohshëm i shumave në llogaritë bankare të debitorit, në zbatim të urdhrin të përmbauesit gjyqësor;

d) “Transferim i shumës” është transferimi në llogarinë bankare të përmbauesit gjyqësor - apo sipas urdhrin të këtij të fundit, në llogarinë e kreditorit - i shumës mbi të cilën është vendosur sekuestroja;

e) “Urdhër për vendosjen e sekuestros” është akti shkresor i përmbauesit gjyqësor, i cili urdhëron bankën për vendosjen e sekuestros;

f) “Urdhër për heqjen e sekuestros” është akti shkresor i përmbauesit gjyqësor, i cili urdhëron bankën për heqjen e sekuestros;

g) “Urdhër për transferimin e shumës” është akti shkresor i përmbauesit gjyqësor, i cili urdhëron bankën për transferimin e shumës, objekt detyrimi i debitorit në një llogari bankare të përcaktuar në urdhrin e përmbauesit gjyqësor;

h) “Llogari” nënkupton “llogari bankare”, “depozitë bankare” dhe çdo “kredi” (të drejta) në emër të debitorit, ose çdo pjesë takuese e tij, duke përjashtuar produktet bankare vijuese, garanci bankare, letërkredi, overdraft.

4. Urdhri për vendosjen e sekuestros

4.1 Përmbauesi gjyqësor ka të drejtë të urdhërojë vendosjen e sekuestros në shumat në llogarinë e debitorit, në të gjitha bankat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

4.2 Urdhri për vendosjen e sekuestros paraqitet në formë të shkruar dhe përmban minimalisht:

a) Të dhëna për identifikimin e debitorit:

i) emrin, mbiemrin, atësinë dhe datëlindjen (për individët);

ii) emrin dhe numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (për personat fizikë dhe për personat juridikë);

b) Shumën për të cilën vendoset sekuestro;

c) Urdhrin e ekzekutimit të lëshuar nga gjykata kompetente, ose çdo akt mbi të cilin bazohet fillimi i procesit të ekzekutimit të detyrueshëm.

5. Detyrimi i bankave për të vendosur sekuestron dhe për të informuar përmbauesin gjyqësor

5.1 Banka, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e urdhrin për vendosjen e sekuestros, vendos sekuestron në shumat, të cilat gjenden në llogarinë e debitorit, në momentin e marrjes së urdhrin, deri në shumën e përcaktuar në urdhër. Kur shumata e disponueshme në llogari është më e

vogël se shuma e përcaktuar në urdhër, banka vendos sekuestro mbi të gjithë këtë shumë.

Banka vendos sekuestron për shumën, të cilat do të bëhen të disponueshme në llogari, deri në plotësimin e shumës së përcaktuar në urdhrin për vendosjen e sekuestrës.

5.2 Banka njofton përmbartesin gjyqësor për vendosjen e sekuestrës, brenda 3 ditësh pune nga marrja e urdhrin. Përmbartesi urdhëron transferimin e shumës ose heqjen e sekuestrës për këtë shumë, brenda 10 ditësh pune nga marrja e njoftimit të bankës, në të kundërt masa e sekuestrës konsiderohet e rënë.

5.3 Banka njofton përmbartesin gjyqësor brenda 3 ditësh pune nga marrja e urdhrin për vendosjen e sekuestrës, kur llogaria e debitorit nuk ka gjendje pozitive. Banka vendos sekuestron vetëm nëse në këtë llogari do të bëhen të disponueshme shumën të cilat do të krijojnë një gjendje pozitive.

5.4 Përmbartesi gjyqësor mund të kërkojë informacion nga banka, në çdo kohë, për gjendjen e llogarisë mbi të cilën është vendosur sekuestroja. Banka i kthen përgjigje përmbartesit gjyqësor brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kërkesës. Në rast se në llogari janë sekuestruar shumën të tjera, të cilat përbëjnë gjendje pozitive, përmbartesi urdhëron transferimin e shumës ose heqjen e sekuestrës, brenda 10 ditësh pune nga data e marrjes së konfirmimit me shkrim të bankës, në të kundërt masa e sekuestrës konsiderohet e rënë.

5.5 Banka nuk vendos sekuestron dhe njofton përmbartesin gjyqësor brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e urdhrin për vendosjen e sekuestrës, kur konstatohet se ky urdhër nuk përmban elementet e përcaktuara në pikën 4.2 të këtij udhëzimi.

5.6 Kur urdhri për vendosjen e sekuestrës ka paqartësi apo gabime materiale të dukshme në identifikimin e debitorit, apo shumës për të cilën duhet kryer ekzekutimi, banka vendos sekuestron dhe i njofton përmbartesit gjyqësor parregullsitë e urdhrin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e urdhrin për vendosjen e sekuestrës.

Përmbartesi gjyqësor, brenda 3 ditësh pune nga marrja dijëni e njoftimit të bankës, rregullon gabimet apo paqartësitë e konstatuara dhe njofton bankën.

Në mungesë të përgjigjes nga ana e përmbartesit gjyqësor, në përfundim të afatit 3-ditor, masa e sekuestrës konsiderohet e rënë.

5.7 Sekuestroja në llogarinë e debitorit nuk pezullon pagimin e kredive që, sipas nenit 605 të Kodit Civil, paguhet me preferim ndaj urdhrin për sekuestro. Kur shumën e sekuestruar në llogari, nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e paraqitura për ekzekutim, banka njofton përmbartesin gjyqësor, i cili respekton radhën e referimit, që përcaktohet në nenin 605 të Kodit Civil.

Sekuestroja konsiderohet e rënë, në rast se përmbartesi gjyqësor nuk i komunikon radhën e preferimit, brenda 10

ditësh pune nga marrja dijëni për njoftimin e bankës.

5.8 Sekuestroja në llogarinë e debitorit hiqet me urdhër të përmbartesit gjyqësor, si dhe konsiderohet e rënë në rastet e parashikuara në këtë udhëzim.

5.9 Kur sekuestroja vendoset në bazë të një vendimi gjykate për sekuestrimin e shumave në llogari (sigurim padie), heqja e sekuestrës bëhet me urdhër të përmbartesit gjyqësor, ose paraqitjes pranë bankës të vendimit të gjykatës që urdhëron heqjen e sekuestrës.

6. Urdhri për transferimin e shumës

6.1 Përmbartesi gjyqësor, brenda 10 ditësh pune nga data e marrjes së njoftimit të bankës për vendosjen e sekuestrës mbi llogarinë e debitorit, i njofton bankën urdhrin për transferimin e shumës.

6.2 Pika 6.1 nuk zbatohet në rastin e vendosjes së sekuestrës të bazuar në vendimin e gjykatës për sekuestrimin e shumave në llogari (sigurim padie).

6.3 Urdhri i përmbartesit gjyqësor për transferimin e shumës përmban:

a) Të dhënat për identifikimin e debitorit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4.2, shkronja "a" të këtij udhëzimi;

b) Shumën e saktë të detyrimit, si dhe shumën e cila duhet të transferohet;

c) Të dhënat e sakta për emërtimin, numrin e llogarisë dhe bankën, për kalimin e shumës së sekuestruar;

d) Radhën e preferimit, në zbatim të nenit 605 të Kodit Civil, kur ekzistojnë shkaqe preferimi.

6.4 Urdhrin të përmbartesit gjyqësor për transferimin e shumës, i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

a) Vendimi gjyqësor ose çdo akt tjetër, i cili në zbatim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile konsiderohet titull ekzekutiv;

b) Dokumenti postar ose çdo dokument i ngjashëm, i cili vërteton datën e marrjes dijëni nga ana e përmbartesit për njoftimin e bankës, sipas pikave 5.2 dhe 5.4 të këtij udhëzimi.

6.5 Dokumentet që i dërgohen bankës janë, sipas rastit, origjinale ose fotokopje të noteruara, ose të vërtetuara "njësia me origjinalin" nga sekretaria e gjykatës ose fotokopje të njehsuara nga përmbartesi gjyqësor.

6.6 Kur urdhri për transferimin e shumës ka paqartësi apo gabime në elementet e përcaktuara në pikën 6.3, ose mungojnë dhe ka paqartësi ose gabime në dokumentet e përcaktuara në pikën 6.4, banka i njofton përmbartesit gjyqësor këto parregullsi brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e urdhrin për transferimin e shumës.

Shumën në llogari, mbahet e sekuestruar edhe 10 ditë pune të tjera nga dita e marrjes dijëni nga përmbartesi gjyqësor për njoftimin e bankës.

Në mungesë të përgjigjes nga ana e përmbartesit gjyqësor, në përfundim të afatit 10-ditor, masa e sekuestrës konsiderohet e rënë.

7. Procedura për pezullimin dhe pushimin e ekzekutimit

7.1 Pezullimi i ekzekutimit bëhet vetëm kundrejt paraqitjes në bankë të urdhrimit të përmbauesit gjyqësor për pezullimin e ekzekutimit, ose vendimit të gjykatës për pezullimin e ekzekutimit, në përputhje me kriteret e caktuara në Kodin e Procedurës Civile.

7.2 Me marrjen e vendimit të gjykatës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, banka njofton përmbauesin gjyqësor brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e vendimit të pezullimit.

7.3 Në rast se pas pezullimit të ekzekutimit bëhen të disponueshme shuma të tjera në llogarinë e debitorit, këto shuma nuk i nënshtrohen urdhrimit për vendosjen e sekuestros.

7.4 Pezullimi i ekzekutimit nuk sjell si pasojë heqjen e sekuestros mbi shumat që janë sekuestruar tashmë nga banka.

7.5 Në rastin e pushimit të ekzekutimit, heqja e sekuestros në llogaritë e debitorit bëhet vetëm me urdher të përmbauesit gjyqësor, në përputhje me nenin 617 të Kodit të Procedurës Civile.

8. Dosja e procedurës përmbaimore

Për çdo procedurë vendosje sekuestroje, banka mban një dosje të plotë ku përfshihen:

a) Urdhurat e përmbauesve gjyqësor, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas dispozitave të këtij udhëzimi;

b) Korrespondenca me përmbauesit gjyqësorë; dhe

c) Korrespondenca e brendshme e bankës, përfshirë edhe komunikimet elektronike, të cilat lidhen me praktikën përmbaimore.

Dokumentacioni i mësipërm mund të jetë edhe kopje e origjinalit.

9. Verifikimi i dokumentacionit bankar nga përmbauesi gjyqësor

9.1 Në zbatim të nenit 598 të Kodit të Procedurës Civile, përmbauesi gjyqësor ka të drejtë të verifikojë në vend dokumentacionin bankar, që lidhet drejtpërdrejt me ekzekutimin, në prani të punonjësit të ngarkuar nga administratorët e bankës, kur ai ka bazë të dyshojë se banka:

a) Nuk ekzekuton pa arsye detyrimin tërësisht ose pjesërisht;

b) Shkel afatet e ekzekutimit të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, si dhe në këtë udhëzim;

c) Nuk respekton radhën e preferimit të përcaktuar nga përmbauesi gjyqësor.

9.2 Verifikimi i kryer në kuptimin e pikës 9.1, dokumentohet me procesverbal, një kopje të të cilit e mban banka.

10. Të fundit

10.1 Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 43, datë 11.6.2003, për miratimin e udhëzimit "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka", i ndryshuar, shfuqizohet.

10.2 Për urdhrat e vendosjes së sekuestros, ose transferimit të shumës të lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të zbatohet udhëzimi "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 43, datë 11.6.2003, i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani**

KËRKESË

Shtetaset Valentina Bardhi, Sonila Bardhi dhe Romina Bardhi kërkojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të bashkëshortit dhe babait të tyre, Vahit Ramadan Bardhi, si dhe caktimin si kujdestare të pasurisë së tij kërkuar Sonila Bardhi.

**KËRKUESE
Sonila Bardhi, Romina Bardhi, Valentina Bardhi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006